

VENDIM
Nr. 13, datë 9.1.2025

PËR TRANSFERIMIN TE KORPORATA E INVESTIMEVE SHQIPTARE TË PRONAVE SHTETËRORE NR. 336, NR. 338/1, NR. 318, NR. 310, NR. 324/2, NR. 324/4, ZONA KADASTRALE 3852, ME VENDNDODHJE NË XHAFZOTAJ, BASHKIA SHIJAK, DHE PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 185, DATË 27.3.2024, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR KALIMIN NGA RADIOTELEVISIONI SHQIPTAR NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI TË MINISTRISË SË EKONOMISË, KULTURËS DHE INOVACIONIT TË PASURIVE TË PALUAJTSHME SHTETËRORE NR. 336, NR. 338/1, NR. 318, NË ZONËN KADASTRALE 3852, XHAFZOTAJ, BASHKIA DURRËS, DHE MIRATIMIN E HAPJES SË PARKUT TEKNOLOGJIK DHE SHKENCOR ‘*DURANA TECH PARK*’”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 1, të nenit 7, të ligjit nr. 71/2019, “Për Korporatën e Investimeve Shqiptare”, të neneve 13 e 15, të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001, “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, dhe në zbatim të shkronjës “a”, të pikës 1, të kreut II, të vendimit nr. 137, datë 6.3.2024, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e kriterëve dhe të procedurës për dhënien e pronës shtetërore me qira, enfitozë, *leasing*, shitje, përdorim si kolateral dhe të përdorimit në forma të tjera nga ana e Korporatës së Investimeve Shqiptare”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Transferimin në pronësi të shoqërisë aksionare “Korporata e Investimeve Shqiptare”, me NIPT: M01917011D, të pronave shtetërore sipas shtojcës nr. 1, bashkëlidhur këtij vendimi, në përgjegjësi administrimi të ministrisë përgjegjëse për ekonominë, sipas dokumentacionit/kartelave të pronësisë, që i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse të tij.

2. Kalimin nga Radiotelevizioni Shqiptar në pronësi të shoqërisë aksionare “Korporata e Investimeve Shqiptare”, me NIPT: M01917011D, të pronave shtetërore sipas shtojcës nr. 2, bashkëlidhur këtij vendimi, me vendndodhje në Xhafzotaj, Bashkia Shijak, sipas dokumentacionit/kartelave të pronësisë, që i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse të tij.

3. Korporata e Investimeve Shqiptare në rolin e zhvilluesit të parkut teknologjik dhe shkencor “*Durana Tech Park*” apo entiteti i krijuar prej saj do të përdorë pasuritë e paluajtshme shtetërore me nr. 338/1, nr. 318, nr. 310, nr. 324/2, nr. 324/4, zona kadastrale 3852, me vendndodhje në Xhafzotaj, Bashkia Shijak, në funksion të parkut teknologjik dhe shkencor “*Durana Tech Park*”, të hapur me vendimin nr. 185, datë 27.3.2024, të Këshillit të Ministrave, “Për kalimin nga Radiotelevizioni Shqiptar në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit të pasurive të paluajtshme shtetërore nr. 336, nr. 338/1, nr. 318, në zonën kadastrale 3852, Xhafzotaj, Bashkia Durrës, dhe miratimin e hapjes së parkut teknologjik dhe shkencor “*Durana Tech Park*”.

4. Autorizohet Korporata e Investimeve Shqiptare, vetë apo nëpërmjet entitetit të krijuar prej saj, të kryejë veprimet me institucionet publike kompetente për planifikimin e zhvillimin e territorit, apo me institucione të tjera, në kuadër të realizimit të parkut teknologjik dhe shkencor “*Durana Tech Park*”, si dhe të bashkëpunojë me Agjencinë Shtetërore të Kadastrës për konsolidimin e pronës.

5. Në funksion të realizimit të parkut teknologjik dhe shkencor “*Durana Tech Park*”, të përcaktuar në këtë vendim, në përputhje me parashikimet ligjore përkatëse për planifikimin dhe

zhvillimin e territorit, autorizohet Korporata e Investimeve Shqiptare për të proceduar me prishjen e objekteve, pjesë e pronave të përcaktuara në shtojcat nr. 1 dhe nr. 2, bashkëlidhur këtij vendimi.

6. Në vendimin nr. 185, datë 27.3.2024, të Këshillit të Ministrave, bëhen këto ndryshime:

a) Titulli i vendimit ndryshohet dhe zëvendësohet me “Për miratimin e hapjes së parkut teknologjik dhe shkencor ‘Durana Tech Park’”.

b) Pika 1 shfuqizohet.

7. Ngarkohen Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, Radiotelevizioni Shqiptar, Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit, Agjencia Shtetërore e Kadastrës dhe Korporata e Investimeve Shqiptare për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR

Edi Rama

SHTOJCA NR. 1
PRONAT QË TRANSFEROHEN NË PRONËSI TË KORPORATËS

Nr.	Zona kadastrale	Nr. i pasurisë	Sip. e pasurisë (m ²)	Nga sip.		Institucioni me përgjegjësi administrimi/ pronësi
				Truall (m ²)	Ndërtesë (m ²)	
1	3852	336	140400	-	-	Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit VKM nr. 185, datë 27.3.2024, “Për kalimin nga Radiotelevizioni Shqiptar në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, të pasurive të paluajtshme shtetërore nr. 336, nr. 338/1, nr. 318, në zonën kadastrale 3852, Xhafzotaj, Bashkia Durrës, dhe miratimin e hapjes së parkut teknologjik dhe shkencor ‘Durana Tech Park’”
2	3852	338/1	40600	40600		Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit VKM nr. 185, datë 27.3.2024, “Për kalimin nga Radiotelevizioni Shqiptar në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, të pasurive të paluajtshme shtetërore nr. 336, nr. 338/1, nr. 318, në zonën kadastrale 3852, Xhafzotaj, Bashkia Durrës, dhe miratimin e hapjes së parkut teknologjik dhe shkencor ‘Durana Tech Park’”
3	3852	318	81200	-	-	Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit VKM nr. 185, datë 27.3.2024, “Për kalimin nga Radiotelevizioni Shqiptar në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, të pasurive të paluajtshme shtetërore nr. 336, nr. 338/1, nr. 318, në zonën kadastrale 3852, Xhafzotaj, Bashkia Durrës, dhe miratimin e hapjes së parkut

						teknologjik dhe shkencor "Durana Tech Park"
--	--	--	--	--	--	---

SHTOJCA NR. 2
PRONAT QË TRANSFEROHEN NË PRONËSI TË KORPORATËS

Nr .	Zona kadastrale	Nr. i pasurisë	Sip. e pasurisë (m ²)	Nga sip.		Institucioni me përgjegjësi administrimi/pronësi
				Truall (m ²)	Ndërtesë (m ²)	
1	3852	310	108100	108100		Radiotelevizioni Publik Shqiptar
2	3852	324/2	5200	5200	3000	Radiotelevizioni Publik Shqiptar
3	3852	324/4	139 565.5	-	-	Radiotelevizioni Publik Shqiptar